

SBASHK Arsimimi sot

Janar, 2025

Gazeta elektronike

SBASHK mbajti tryezë diskutimi për gjendjen e sindikatave në 4 vitet e fundit në Kosovë



SBASHK organizoi një tryezë diskutimi lidhur me situatën e krijuar në katër vitet e fundit në Kosovë, ku u shpërfaq gjendja e punëtorve arsimor por edhe anëtarëve të sindikatave tjera, e cila u tha se është e rëndë... (faqe 4)

Bisedë me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj



Urojmë që ky vit të jetë i mbarë për SBASHK-un dhe sindikatat tjera ... (faqe 3)

SBASHK mori pjesë në 80 vjetorin përkujtues të çlirimit të kampit shfarosës, Auschwitz



Udhëheqës të lartë shtetërorë, veprimtarë artistë, por edhe sindikalistë ... (faqe 5)

SBASHK, pjesë e aktivitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës në Irlandë



Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës, që numëron 11 milionë anëtarë ka zhvilluar një aktivitet të rëndësishëm sindikal me temën kyçe ... (faqe 6)

Në janar SBASHK i përfundoi tri grupe të trajnimit dhe i filloi pesë të reja



Muaji janar në SBASHK filloi me shumë aktivitete me trajnime për mësimdhënës duke përfunduar trajnimet e filluara para Vitit të Ri, por edhe me grupe të ... (faqe 7)

Editorial

E veçanta e janarit 2025



Shumë nga muajt e vitit rikthejnë kujtesën në data e ngjarje të dhembjes, por edhe të krenarisë sonë kombëtare. Janari i këtij viti në Kosovë do të kujtohet për takimet e shumta në fushatën zgjedhore. SBASHK-u me kujdes po përcjell nga larg e përmes medieve tubimet zgjedhore dhe deklaratat e kandidatëve për kryeministër, por edhe të pjesëmarrësve të tjerë në këtë garë, që me votën e qytetarëve do të nxjerr Qeverinë e re, por edhe përfaqësuesit e popullit në Parlamentin e Kosovës. Ne arsyeshëm po dëgjojmë me kujdes të shtuar ato që ata po thonë për arsimin në Kosovë dhe premtimet po zgjojnë entuziazëm shoqëruar me lutjen që premtimet të mbahen. SBASHK-u uron që pas 9 shkurtit të kemi institucione

e udhëheqës që kanë qasje të drejtë ndaj dialogut dhe që kanë prirje të dëgjojnë zërin e sindikatave, që është zëri i të punësuarve në arsim dhe në sektorët tjerë. Urojmë që kurrë më mos të ndodhin tendenca për ikje nga dialogu dhe për shuarje të organizimit sindikal. Urojmë që me dialog e mirëkuptim të realizohen kërkesat legjitime të punëtorëve arsimorë, që nga çerdhet e deri në universitete, por edhe të policisë, administratës, pensionistëve, zjarrfikësve, të ushtrisë dhe gjithë të punësuarve në sektorin publik dhe atë privat. Ne jemi të gatshëm dhe në pritje që kjo të ndodh. Urojmë që fushata të përmbillet e qetë dhe 9 shkurti ta shpreh vullnetin e punëtorëve arsimorë dhe gjithë të tjerëve.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spotete në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Bashkëbisedim

Bisedë me kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj

Urojmë që ky vit të jetë i mbarë për SBASHK-un dhe sindikatat tjera

Në kuadër të përgatitjes së shkrimeve për gazetën “Arsimimi sot” të muajit janar biseduam me kryetarin e SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili që në fillim të bisedës uroi që viti 2025 të jetë i mbarë për SBASHK-un , por edhe për sindikatat tjera. Ai edhe kësaj radhe bëri një përshkrim të angazhimeve e sfidave në vitin 2024, por edhe në vitet tjera, duke ritheksuar se katër vitet e shkuara ishin tepër të vështira për organizimin sindikal sepse në vend të dialogut e marrëveshjeve në shërbim të realizimit të kërkesave legjitime të anëtarësisë kishim vazhdimisht qasje të gabuar të Qeverisë ndaj dialogut social dhe ndaj kërkesave të shumta e legjitime të anëtarësisë sonë, të cilat janë publikuar përmes medieve , por janë bërë publike zëshëm edhe në protestat e 1 majit dhe 4 dhjetorit.

Jasharaj në këtë bisedë ndalet edhe të aktivitetet tjera në vitin 2024 e të cilat po vazhdojnë edhe në janarin e këtij viti duke veçuar takimet e vazhdueshme me veprimtarë sindikalë e me pjesëmarrës në trajnime me të cilët bashkëbisedohet shtruar dhe duke analizuar situatën aktuale edhe analizohen me kujdes idetë nga shumë anëtare e anëtarë e që kanë të bëjnë me angazhimin sindikal të SBASHK-ut. Jasharaj tregon se stafi qendror po vazhdon me angazhimet për realizimin e detyrave konkrete dhe për të realizuar kërkesat e anëtarësisë duke përmendur edhe trajnimet, të cilat vazhdojnë të zgjojnë interesim të madh të anëtarësisë, të cilët i kanë kthyer vikendet në ditë të aktiviteteve me qëllim që të marrin njohuri të reja e ato t’i vënë në përdorim për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në arsim.

Jasharaj me krenari përmend dhe angazhimet e përfaqësuesve të SBASHK-ut në aktivitetet ndërkombëtare sindikale dhe kontributin e tyre të çmuar në prezantimin e dinjitetshëm të sindikatës sonë në këto aktivitete dhe takimet e shumta që ata zhvillojnë me udhëheqësit më të lartë të Unionit të Sindikatave të Arsimit të

Evropës , të Internacionales Botërore të Arsimit dhe me kryetarë të sindikatave simotra në shumë shtete të Ballkanit , Evropës e botës. Kryetari Jasharaj thekson se në vazhdim të aktiviteteve dhe realizimit të detyrave konkrete SBASHK-u ka përgatitur një platformë për dialog me institucionet që do të dalin nga vota e 9 shkurtit e po ashtu do të bëhen përgatitje me kohë edhe për shënimin e datës së madhe të mësuesit dhe shkollës shqipe dhe për aktivitetet tjera që janë të planifikuara për çdo muaj të vitit 2025.



Gjatë muajit

SBASHK mbajti tryezë diskutimi për gjendjen e sindikatave në 4 vitet e fundit në Kosovë



SBASHK organizoi një tryezë diskutimi lidhur me situatën e krijuar në katër vitet e fundit në Kosovë, ku u shpërfaq gjendja e punëtorve arsimor por edhe anëtarëve të sindikatave tjera, e cila u tha se është e rëndë.



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, tha se qeveria Kurti jo vetëm që nuk ka bashkëpunuar dhe përkrahur sindikatat në Kosovë, por ka qenë kundërshtarë e tyre dhe gati armiqësore karshi kërkesave të mësimdhënësve dhe punonjësve tjerë në Kosovë.

I pranishëm me diskutime në këtë tryezë ishte edhe dejtori i Institutit për Politika Sociale, “Musine Kokalari” Visar Ymeri, i cili tha se, Ministria e Financave nuk e ka rolin vetëm të ndarjes së buxhetit në Kosovë, por edhe krijimin e politikave për zgjidhjen e kërkesave të punonjësve, në këtë rast të arsimit.

Kurse, Naim Jakaj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, tha se nëse nuk vepron për ndryshimin e Ligjit të Pagave, IKD do të iniciojë padi në emër të 84 mijë shërbyesve civil. “IKD do të iniciojë padi në emër të 84 mijë shërbyesve civil të prekur nga kjo situatë”, tha ai.

Pakënaqësitë e tyre i shprehën edhe përfaqësuesit e disa sindikatave tjera në Kosovë si ai i BSPK-së, Atdhe Hykolli, i Sindikatës së Policisë së Kosovës, Avdi Hoti, përfaqësuesi i Sindikatës së Energjetikës së Kosovës, Avni Grajçevci, ai i Sindikatës së Pavarur të Minatorëve të Trepçës, Ibrahim Januzi, përfaqësuesi i Sindikatës së Punëtorëve të RTK-së, Gëzim Bimbashi.



Të pranishëm në diskutim ishin edhe disa nga kryetarët e Sindikatave Komunale të Arsimit dhe anëtarë tjerë të SBASHK-ut.

Pjesëmarrësit në këtë tryezë kanë nxjerr konkluzione në formë të një strategjie për angazhime të përbashkëta të sindikatave në Kosovë, duke forcuar solidaritetin mes tyre në përballje me cilën do sfidë të kohës.



SBASHK mori pjesë në 80 vjetorin përkujtues të çlirimit të kampit shfarosës, Auschwitz



Udhëheqës të lartë shtetërorë, veprimtarë artistë, por edhe sindikalistë nga e tërë Evropa e bota ishin bërë bashkë në përkujtimin e 80-vjetorit të çlirimit të kampit nazist gjerman të përqendrimit. Në këtë përvjetor të përkujtimit kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të SBASHK-ut, të cilët bashkë me koleget e kolegët e tyre nga Ballkani, Evropa e tërë bota kanë lartësuar kujtimin për miliona viktime që përjetuan tmerr e shfarosje në këtë kamp përqendrimi, duke u lutur që tragjadi të tilla kurrë të mos përsëriten më. Kjo lutje e përbashkët është bërë gjatë vizitës në Muzeun Auschwitz e pastaj janë mbajtur takime e Konferencë kushtuar 80 vjetorit të çlirimit të këtij kampi.



Pjesëmarrësit e këtij aktiviteti përkujtues kanë vizituar lagjen e vjetër hebraike në Kazimierz, duke përfshirë sinagogën më të vjetër në Poloni dhe një nga ndërtesat më

të rëndësishme fetare hebraike në Evropë.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut dhe gjithë sindikatave të arsimit ishin pjesë e Konferencës përkujtuese me moton “Kujtimi jemi ne”



Por zhvilluan takime të shumta me udhëheqësit më të lartë të Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, të Internacionales Botërore të Arsimit dhe me përfaqësues të sindikatave simotra nga Ballkani, Evropa e bota për të forcuar bashkëpunimin sindikal, që është tepër i nevojshëm në këto kohë kur sindikatat po përballën me sfida të shumta në përpjekje për të realizuar misionin e tyre në mbrojtje dhe realizim të kërkesave të anëtarësisë.



Përfaqësuesit e SBASHK-ut- pjesëmarrës në Konferencën finale në Bruksel, me temën: “Shkollat si institucione të të mësuarit-partneri social i arsimit të evropës, promovon cilësinë efektive dhe modelet inovative të udhëheqjes në sektorin e arsimit pas pandemisë Covid19”



Nënkryetarja e SBASHK-ut, Vjollca Shala dhe Sekretari i Përgjithshëm, Ymer Ymeri, kanë marrë pjesë po ashtu në Konferencën finale në Bruksel me temën “Shkollat si institucione të të mësuarit-partneri social i arsimit të evropës, promovon cilësinë efektive dhe modelet inovative

të udhëheqjes në sektorin e arsimit pas pandemisë Covid19”.



Qëllimi i konferencës ishte diskutimi mbi gjendjen e institucioneve arsimore pas pandemisë Covid19, dhe hapat që duhet të ndërmerren me qëllim të përmirësimit të cilësisë në sistemin arsimor, tani më kur kemi mungesë të madhe të numrit të mësimeve pothuajse në gjithë evropën. Aty u paraqitën edhe modelet të menaxhimit të inovacionit dhe të menaxhimit të cilësisë në praktikë nga perspektiva e partnerëve social. Nga ky takim u nxorën edhe rekomandime politike për të ardhmen.

SBASHK, pjesë e aktivitetit të Sindikatave të Arsimit të Evropës në Irlandë



Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës, që numëron 11 milionë anëtarë ka zhvilluar një aktivitet të rëndësishëm sindikal me temën kyçe “Sindikatat e arsimit mbështesin përfshirjen e refugjatëve dhe emigrantëve në arsim”. Në këtë tryezë në mesin e 64 përfaqësuesve sindikalë nga e tërë Evropa kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e SBASHK-ut, nënkryetarja Vjollca Shala dhe sekretari i përgjithshëm Ymer Ymeri, të cilët kanë prezantuar përvojat e shkëlqyera të mësimeve të Kosovës, të cilët pasdëbimit me dhunë të popullatës së Kosovës nga pushtuesi serb, kishin organizuar mësimin në Maqedoni, Shqipëri e Mal të Zi me fëmijët e Kosovës duke bërë që



të shërohen sado pak plagët dhe traumat e luftës dhe duke bërë të mundur vazhdimin e vitit shkollor, që ishte ndërprerë pas gjithë atyre masakrave e vrasjeve që bëri makineria vrasëtare e pushtuesit serb kudo në Kosovë. Prania dhe kontributi i çmuar që SBASHK jep në të gjitha aktivitetet sindikale në Evropë e botë dëshmon për përkushtimin që Kosova të prezantohet në mënyrë të denjë dhe për respektin meritohet që SBASHK-u gëzon nga Unioni i Sindikatave të Arsimit të Evropës dhe nga Internacionalja Botërore e Arsimit, që numëron 32 milionë anëtarë e të cilat vazhdimisht e kanë përkrahur sindikatën e arsimit të Kosovës për hir të përkushtimit

e angazhimit maksimal të saj në mbrojtjen e të drejtave dhe realizimit të kresave të anëtarësisë. SBASHK në Irlandë mori pjesë në tryezën “Përmes dhe nëpërmjet arsimit: Sindikatat e Arsimit mbështesin përfshirjen e refugjatëve dhe migrantëve”

SBASHK në fillimvit ishte pjesë e tryezës së dytë të rrumbullaktët me temën “Përmes dhe nëpërmjet arsimit: Sindikatat e Arsimit mbështesin përfshirjen e refugjatëve dhe migrantëve”, e cila është një iniciativë e rëndësishme që trajton rolin e sindikatave të arsimit në promovimin e përfshirjes së refugjatëve dhe migrantëve përmes sistemit arsimor. Kjo ngjarje ishte zhvilluar në Dublin të Irlandës gjatë muajit janar dhe kishte mbledh përfaqësues nga sindikatat e arsimit të vendeve të ndryshme evropiane për të ndarë përvoja, sfida dhe praktikat më të mira për ndërtimin e një arsimit gjithëpërfshirës.



ngjarje kishte marrë pjesë edhe SBASHK-u me dy përfaqësues, të cilët kishin ndarë përvojat e tyre dhe kishin kontribuar në diskutimet për politikën dhe strategjitë që promovojnë barazinë dhe përfshirjen. Pikat kryesore të diskutimit ishin: Strategjitë për mbështetje dhe integrim, Diskutimi mbi qasjet dhe masat

që ndihmojnë refugjatët dhe migrantët të përfshihen në mënyrë efektive në sistemin arsimor, duke marrë parasysh sfidat gjuhësore, kulturore dhe sociale.



Politikat për barazi dhe përfshirje: Identifikimi i politikave që mundësojnë trajtimin e të gjithë nxënësve në mënyrë të barabartë dhe krijimin e mjediseve të sigurta dhe mbështetëse për të gjithë.

Roli i sindikatave: Analiza e mënyrave se si sindikatat mund të ndikojnë në mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve dhe migrantëve, duke u bërë zëdhënës për përfshirjen dhe trajtimin e drejtë në arsim.



Pjesëmarrja e SBASHK-ut në këtë tryezë ishte një mundësi e rëndësishme për të forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar dhe për të ndarë përvojat nga Kosova në drejtim të mbështetjes dhe përfshirjes së refugjatëve dhe migrantëve në arsim.

Trajnime

Në janar SBASHK i përfundoi tri grupe të trajnimit dhe i filloi pesë të reja

Muaji janar në SBASHK filloi me shumë aktivitete me trajnime për mësimdhënës duke përfunduar trajnimet e filluara para Vitit të Ri, por edhe me grupe të reja të trajnimeve të cilat filluan menjëherë pas festave.

Menjëherë pas përfundimit të festave zyrtare të Vitit të Ri, SBASHK organizoi testet për mësimdhënësit e Vitisë, të cilët e kishin përfunduar me sukses trajnimin “Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie”, derisa gjatë testimit i pranishëm ishte edhe kryetari Rrahman Jasharaj.



SBASHK organizoi testin edhe për një grup të mësimdhënësve të Drenasit, të cilët e kishin përfunduar trajnimin në programin "Aplikimi i programeve kompjuterike në mësimdhënie". Testi u administrua nga Sekretari i Përgjithshëm në SBASHK, Ymer Ymeri dhe zyrtari ligjor, Blendor Shatri, kurse i pranishëm ishte edhe kryetari i SKAP-it për Viti, Kemajl Bislimi dhe trajneri Musli Neziri.



Në Viti, për vizitë qëndroi edhe kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili përcolli nga afër mbarëvajtjen e testit dhe u informua nga afër me kërkesat e mësimdhënësve.

Testi në Drenas u mbajt të shtunën nga Sekretari i Përgjithshëm i SBASHK-ut, Ymer Ymeri së bashku me zyrtaren Afërdita Ahmeti. Ndërkohë i pranishëm ishte edhe kryetari i SKAP-it për këtë komunë, Ilaz Dervishi si dhe trajnerja e përzgjedhur nga SBASHK, Arbenita Gashi. Gjatë muajit të parë të këtij Viti, SBASHK filloi edhe me katër grupe tjera të trajnimeve, ku në programin "Forcimi i kapaciteteve për udhëheqje të dialogut social", dy grupe filluan në Pejë, me trajnerë Ilir Gashi dhe Addhe Krasniqi dhe një në Gjilan me trajner Rexhep Arifi. Kurse në programin "Aplikimi I programeve kompjuterike në mësimdhënie", SBASHK i filloi edhe dy grupe të reja të trajnimit në Pejë, me trajner Burim Krasniqi.



Grupet e trajnimit në Pejë i kishte vizituar kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, i cili mësimdhënësve u kishte dëshiruar suksese sa me të larta në ngritjen profesionale, I shoqëruar nga kryetari i SKAP-it për Pejë, Isuf Lajçi.

Kurse në Gjilan kishte qëndruar kryetari i SKAP-it për këtë komunë, Blerim Mehmeti, i cili ishte kujdesur nga afër për mbarëvajtjen e trajnimit.



SKAP në Malishevë nënshkroi marrëveshje me laboratorin Avicena në këtë komunë



Kryetari i Sindikatës Komunale të Arsimit Paruniversitar (SKAP) në Malishevë, Skender Gashi dhe drejtori i AVICENA - KS - SHPK, Amar Shuki, kanë nënshkruar një Marrëveshje bashkëpunimi (kontratë për shërbime). Qëllimi i marrëveshjes është që të gjithë mësimdhënësit sindikalist të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut, do të mund të marrin shërbime laboratorike mjekësore me zbritje prej 20 % në Laboratorin "AVICENA" në Malishevë. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi prej datës: 20. 01. 2025, dhe është me afat të pacaktuar. Me këtë rast, kryetari i SKAP-it në Malishevë, z.Gashi, e falenderoj përzemërsisht drejtorin e AVCENA-KS, z. Amir Shukin, dhe njëherit i ndau mirënjohje për ofertën dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje bashkëpunuese (Kontrate Marrëveshje).